

Njoftim

Sot, më datë **30.03.2023**, ora **15:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Edlira Petri (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen që i përket:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar në seancë nga Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Person i tretë: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar në seancë nga Altin Kaziaj dhe Franci Nuri.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 32, datë 21.03.2023 të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
Shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.
Plotësimin e të metave nga ana e kërkuarit Partia e Lirisë duke ndryshuar Marrëveshjen e Koalicionit duke hequr Partinë Demokratike e Shqipërisë nga referimi në këtë dokument.

Baza ligjore: Nenet 21, 64, 65 dhe 66, 124, 124/1, 145 e në vazhdim të Kodit Zgjedhor; Nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr.01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

me Vendimin Nr. 6, datë 30.03.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palëve siç janë kryer.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 30.03.2023.

Tiranë, me 30.03.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë